

**STATUT I SHOQERISE**  
**“D.R.K Consulting & Engineering” Sh.P.K.**

*Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.*

Sot, me 08 Shkurt 2022, personat e mëposhtem:

**Z.Artan Roku**, shtetas Shqiptar, lindur me 14.11.1987 ne Kucovë, e banues ne Tirane, mbajtës i leternjoftimit nr. **033455345** dhe numrit personal **I71114052D**.

madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

dhe

**Z.Laidi Dema**, shtetas Shqiptar, lindur me 06.04.1981 ne Shkodër, e banues ne Tirane, mbajtës i leternjoftimit nr. **032973367** dhe numrit personal **I10406237C**.

madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

dhe

**Z.Andi Kallaçej**, shtetas Shqiptar, lindur me 30.03.1992 ne Shkodër, e banues ne Tirane, mbajtës i leternjoftimit nr. **037020024** dhe numrit personal **J20330089W**.

madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

ne përputhje me LigjinNr.9901, date 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe me legjislacionin e zbatueshëm ne Republikën e Shqipërisë, miratoi këtë Statut si vijon:

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” është ky Statut i Shoqërisë;

**Kreu I**  
**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1**  
**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më 08 Shkurt 2022, themeluesit e mësipërm, vendosen te krijojne një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregtar “**D.R.K Consulting & Engineering**” SH.P.K.



## Neni 2 Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

### 1. Projektim/Instalim/Supervizim

- a. Impianteve te prodhimit te energjise elektrike per objekte civile e industriale
- b. Nenstacione elektrike, primar sekondar, linja te tensionit te larte
- c. Kabina elektrike TM/TU si edhe linjat e tensionit te ulet dhe te mesem
- d. Rrjete te telekomunikacionit, fiber optik, citofonise, fonise, internetit, TV, access kontroli, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimi te zjarrit etj., per objektet civile e industriale
- e. Sisteme te energjitike të rinovueshme, panele diellore
- f. Rrjete kabllore dhe optike per sistemin e telekomunikacionit
- g. Sistemeve te komunikimit, VOIP, WEB Pages, DataBase, Digital Asset Management, Digital Logging, Monitoring e Analyzing etj.
- h. Punime, germime, instalim shtylla, ndertime e rikonstruksione ne objekte civile dhe industriale

### 2. Sherbime, Konsulence, Kolaudim dhe Asistence Teknike

- a. Transformator Fuqie/Panele Komutimi/UPS/Stabilizator/Radrizator/Grup Baterish/Sistem Tokezimi/Paneleve Diellore
- b. Konsulence inxhinierike ne fushen e studimit, projektimit, supervizimit dhe ndertimit te linjave elektriket TU dhe TM, telekomunikacionit baker dhe fiber, rrjetit AC dhe DC te ambjenteve teknike, Core Room dhe Data Center
- c. Analiza e Cilësisë dhe Parametrave të Rrjetit te Furnizimit
- d. Permisimi i eficenses dhe auditimit te energjise elektrike
- e. Performance Qualification Report (PQ)
- f. On call service 7/24
- g. Kryerjen e veprimtrise ne fushen e ndertimit, studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrje zbatuese dhe investimin me fonde publike ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi ose administrimi publike ose private
- h. Kryerje e sherbimeve te mirembajtjes riparimit, furnizimit e vendosjes se pjeseve te kembimit dhe materialeve per te gjitha paisjet dhe impiantet

### 3. Trajnim dhe certifikim personeli

- a. Trajnim dhe certifikim per garantimin e sigurise se punes dhe pajisjeve per instalim elektrike
- b. Trajnim dhe certifikim personeli ne rast evakuimi nga zjarri, dhenies se ndihmes se pare, punime ne lartesi, punes i vetem, ngarkesa te renda, ergonomia ne pozicionin e punes
- c. Trajnim dhe certifikim per garantimin e shendetit, sigurise dhe mireqenies te punojesve mbi rregullat absolute
- d. Analiza e riskut ne pune

#### 4. Tregtim

- a. Import-export, tregtim me shumice e pakice, transport, te gjitha llojeve te linjave te rrjeteve elektrike te TU dhe TM, te telekomunikacioni baker dhe fiber, kondicioner, mbrojtje nga zjarri, paisje ngritese dhe transportuese, ndertimi, te destinuara per objekte industriale apo civile, motor gjeneratore, alternatore, stabilizatore e rregullatore tensioni, UPS, invertera, radrizatore, transformatore fuqie TU, TM, TL, panele komandimi, panele elektrike TU, TM, TL, bateri, sisteme fotovoltaike, etj, te destinuara per objekte civile dhe industriale

Kompania ka te drejte te ushtroje cfaredolloj veprimtarie tjeter te lejuar nga ligji dhe ne perputhje me rregullat ne fuqi.

#### Neni 3 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e *pacaktuar dhe/ose e pakufizuar*.

#### Neni 4 Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: *Shqipëri, Tirane FROSINA PLAKU, Ndertesa 68, Hyrja I, Njesia Bashkiake Nr7, 1023.*

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te hape dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

#### Kreu II Kapitali

#### Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **Leke 10,000 (dhjete mije leke)** dhe zotërohet nga ortakët themelues **Artan Roko**, zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 3,334 leke (tremije e treqind e tridhjet e kater lekë) qe perben 33.34% te kapitalit themeltar, dhe **Laidi Dema** zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 3,333 Leke (tremije e treqind e tridhjet e tre lekë) qe perben 33.33% te kapitalit themeltar të shoqërisë, dhe **Andi Kallaçej** zoteruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 3,333 (tremije e treqind e tridhjet e tre lekë) qe perben 33.33 % te kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakut është në para.

Secili ortak do te kete nje numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij.

**Neni 6**  
**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë; shitblerjes; trashëgimisë; dhurimit; çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj. Çdo disponim në favor të një pale të tretë nëpërmjet veprimeve juridike ndërmjet të gjallëve duhet të behet në formë noteriale dhe të regjistrohet. Në rastet e transferimit të pjesëve të kapitalit me kundërshpërblim, ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**


**Neni 8**  
**Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;



- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
  - j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- Per sa kohe qe kapitali themeltar i Shoqerise zotërohet nga nje ortak i vetëm, ky i fundit do te ushtroje kompetencat e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

#### **Neni 9**

#### **Mënyra e Thirrjes se Mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 10**

#### **Kuorumi**


Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 11**

#### **Marrja e vendimeve**



Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

#### Neni 12

#### Përrjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### Neni 13

#### Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efektë pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë për një mandat 5 (pesë) vjeçar emërimi: **Z. Artan Roko**, mbajtës i leternjoftimit nr. **033455345** dhe nr. personal **I71114052D**, shtetase shqiptare, lindur me 14.11.1987 ne Kucovë, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

#### Kreu IV

#### Viti financiar-ekspertet

#### Neni 14

#### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.



## **Neni 15 Ekspertet**

Eksperti ka për detyre që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## **Kreu V Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë**

### **Neni 16 Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim të Asamblesë së Ortakeve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2007; me vendim të gjykatës.

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### **Neni 17 Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakeve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

### **Neni 18 Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 19**  
**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jete kompetente Gjykata Shqiptar.

*Për ndjekjen e procedurave të regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, autorizohet z. Artan Roko, mbajtës i leternjoftimit nr. 033455345 dhe nr. personal 171114052D.*

Ky akt u hartua në gjuhën Shqipe dhe pasi u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortaku themelues si vijon:

**ORTAKET THEMELUES**  
**TE SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**D.R.K Consulting & Engineering SHPK**

**Artan Roko**

*Artan Roko*

**Laidi Dema**

*Laidi Dema*

**Andi Kallaçej**

*Andi Kallaçej*

*[Signature]*